

# FEDERATA E PINGPONGUT E KOSOVËS

## RREGULLORE

### PËR HARTIMIN E RANGLISTËS SË FEDERATËS SË PINGPONGUT TË KOSOVËS

#### **Neni 1.**

Me këtë Rregullore vërtetohet mënyra e vlerësimit të rezultateve të arritura në garat e pingpongut, nga e cila del edhe vlerësimi i suksesshmërisë së përgjithshme të garuesve në formë të ranglistës.

#### **Neni 2.**

Suksesshmëria e tërësishme e garave vërtetohet në fund të stinorit gaarues-rangimi për tërë vitin. Po ashtu vërtetohet edhe rangimi aktual pas çdo gare që pikëzohet gjatë stinorit gaarues.

#### **Neni 3.**

Ranglistat bëhen për të seniorë, seniore, juniorë, kadetë dh kadete. Me rastin e vërtetimit të pozitës në ranglistë merren parasysh vetëm rezultatet e arritura në kategorinë e caktuar.

#### **Neni 4.**

Në fillim të stinorit gaarues, Komisioni profesional i FPPK-së përcakton garat të cilat do të pikëzohen për ranglistë në stinorin vijues.

#### **Neni 5.**

Vlefshmëria e rezultateve sportive shprehet në pikë. Pikët ndahen në bazë të fitoreve individuale, si dhe për plasmanin e arritur, sipas kriterëve të vërtetuara me këtë Rregullore.

#### **Neni 6.**

Ranglistat, sipas të cilave pikëzohen fitoret vetjake, i renditin lojtarët në pesë kategori:

Kategoritë e lojtarëve:

Kategoria I	vendi 1-5 në ranglistën e FPPK-së
Kategoria II	vendi 6-10
Kategoria III	vendi 11-20.
Kategoria IV	vendi 21-30.
Kategoria V	të tjerët.

Për lojtarët e huaj të cilët luajnë në klubet tona, si dhe për lojtarët tanë që luajnë në klubet e huaja, rangimin e caktojnë trajnerët e përzgjedhjeve.

#### **Neni 7.**

Ranglistat e FPPK-së bëhen vetëm për lojtarët dhe lojtaret që janë të regjistruara në FPPK të cilët sipas rregullave të ITTF-së mund të paraqiten për përzgjedhjen e Kosovës.

#### **Neni 8.**

Në të gjitha garat pikëzuese fitohen pikët sipas tabelës 1 e cila është paraqitur në fund të kësaj rregullore.

#### **Neni 9.**

Nëse në një garë në konkurrencën e mashkujve paraqiten më pak se 32 pjesëmarrës, për plasman nën vendin e 16-të lojtarët fitojnë pikë në lartësi prej 50%. Në konkurrencën e femrave nëse paraqiten më pak se 16 pjesëmarrëse për plasman nën vendin 8 lojtaret fitojnë pikë në lartësi prej 50%.

#### **Neni 10.**

Pikët e fituara në kategorinë më të lartë vlejnë edhe për kategorinë më të ulët, por jo edhe anasjelltas (shembull: juniori që merr pikë në kategorinë e seniorëve i llogariten edhe në listën e juniorëve).

#### **Neni 11.**

Garat të cilat pikëzohen për ranglistë në kategorinë e seniorëve-eve, juniorëve-eve dhe kadetëve-eve janë:

- Kampionati vetjak i Kosovës
- Turnetë e pranuar dhe mbështetura nga FPPK
- Turnetë e ftuar
- Top-K turnetë

**Neni 12.**

Pikët mbrojtëse mund të ipen vetëm në rastet kur lojtari nuk paraqitet në garë për shkak të paraqitjes për kombëtare, pasi që trajneri i përzgjedhjes e ka bërë njoftimin më parë. Në atë rast lojtari merr pikët mbrojtëse sikur edhe lojtari që e ka fituar vendin e njëjtë në turneun përkatës, sipas vendit të tij në ranglistë.

**Neni 13.**

Nëse lojtarët në turne nuk mund të fitojnë asnjë ndeshje nuk mund të fitojë asnjë pikë për plasman. Përjashtim bëjnë Top-turnetë e Kosovës, turnetë e ftuar dhe bartësit në kampionatin vetjak të shtetit.

**Neni 14.**

Me propozimin e Komisionit profesional, ndryshimet dhe plotësimet e kësaj Rregulloreje i bënë Bordi i FPPK-së.

**Neni 15.**

Tabela për pikëzimin e plasmanit

TOP 12		Kampionati vetjak i Kosovës		Turnetë e FPPK	
Plasman	Pikët	Plasman	Pikët	Plasman	Pikët
1	125	1	250	1	180
2	105	2	200	2	140
3	95	3	165	3	115
4	85	4	135	4	85
5	75	3 – 4	150	3 – 4	100
6	70	5 – 8	100	5 – 8	70
7	65	9 – 16	50	9 – 16	35
8	60	17 – 32	25	17 – 32	18
9	55				
10	50				
11	45				
12	40				
13	35				
14	30				
15	25				
16	20				

**Neni 16.**

Kjo Rregullore është miratuar në mbledhjen e Kuvendit të FPPK-së të mbajtur më 11.05.2002 dhe hyn në fuqi retroaktivisht duke filluar nga janari i vitit 2002.

Kryetari i FPPK

Sherafedin Zhitia